

Aksidentet Rrugore

Korrik 2021

Tiranë, më 18 Gusht 2021: Në muajin Korrik 2021 numërohen 114 aksidente rrugore nga 130 aksidente të ndodhura në muajin Korrik 2020, duke u ulur me 12,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shtatëmujori i vitit 2021 paraqitet me një rritje prej 23,6 %, ku numërohen 785 aksidente rrugore nga 635 aksidente të ndodhura në shtatëmujorin e parë të vitit 2020.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Korrik 2017 – Korrik 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Korrik 2021, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 175 persona nga 168 që ishte në të njëjtën muaj të një viti më parë. Në shtatëmujorin e vitit 2021, numri i të aksidentuarve është 1,050 persona nga 824 persona në shtatëmujorin e vitit 2020.

Në muajin Korrik 2021, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 13 persona nga 14 persona të vdekur në Korrik 2020. Në shtatëmujorin e 2021, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 118 persona nga 88 persona të vdekur në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Korrik 2021, aksidentet rrugore, në 95,6 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25–34 vjeç, duke zënë

Për publikim 18/08/2021

27,2 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë ulur me 20,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në shtatëmujorin e 2021, aksidentet rrugore, në 15,7 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është rritur 20,6 %, krahasuar me një vit më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Korrik 2020	130	3	11	52	102	
Korrik 2021	114	3	10	51	111	
Ndryshimi vjetor (%)	-12,3	0,0	-9,1	-1,9	8,8	
Janar- Korrik 2020	635	16	72	232	504	
Janar- Korrik 2021	785	25	93	307	625	
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	23,6	56,3	29,2	32,3	24,0	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rugës

Periudha	Aksidentet sipas		Të vdekur	
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Korrik 2020	109	21	14	0
Korrik 2021	109	5	13	0
Ndryshimi vjetor (%)	0,0	-76,2	-7,1	-
Janar- Korrik 2020	533	102	79	9
Janar- Korrik 2021	662	123	104	14
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	24,2	20,6	31,6	55,6

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	Aksidentet sipas moshës së drejtuesit të mjetit					Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	
Korrik 2020	18	39	26	24	16	7
Korrik 2021	25	31	19	19	10	10
Ndryshimi vjetor (%)	38,9	-20,5	-26,9	-20,8	-37,5	42,9
Janar- Korrik 2020	86	197	109	132	69	42
Janar- Korrik 2021	172	212	145	136	72	48
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	100,0	7,6	33,0	3,0	4,3	14,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rrugore dhe numri i të vdekurve sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Korrik 2020	Korrik 2021	Korrik 2020	Korrik 2021	Janar-Korrik 2020	Janar-Korrik 2021	Janar-Korrik 2020	Janar-Korrik 2021
Shqipëria	130	114	14	13	635	785	88	118
Berat	1	0	1	0	4	12	4	0
Dibër	7	1	1	0	30	15	2	4
Durrës	9	9	0	2	60	63	15	11
Elbasan	8	3	1	2	31	37	10	13
Fier	7	14	2	3	52	75	13	20
Gjirokastrë	7	7	0	0	24	48	3	3
Korçë	7	3	0	0	34	30	2	4
Kukës	4	1	0	0	11	27	1	2
Lezhë	15	22	2	1	56	99	9	17
Shkodër	3	5	2	3	12	15	8	9
Tiranë	61	49	4	2	307	351	20	24
Vlorë	1	0	1	0	14	13	1	11

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetvrasjet.

I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (...) mungesë të dhënash